



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Datë 21.05.2025

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin (titulli i projektvendimit): PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT NR. 30, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.1032 RRUGA "ALEKS KOMNENI" DHE PALLATIN "KASTRATI" RRUGA "RAMADAN VELIU" TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019" TË NDRYSHUAR.

Baza ligjore:

Neni 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit" i ndryshuar, ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhëri nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit", i ndryshuar.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër (Çfarë propozohet në projektvendim):

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Komisioni i Posaçëm, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2 bashkëlidhur Vendimit nr. 30, datë 26.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.1032, Rruga "Aleks Komneni" dhe pallatin "Kastrati", Rruga "Ramadan Veliu", të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019", duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, z. Muhamet Vata – numër rendor 13, Alban Tarelli+Irvana Tarelli – numër rendor 66, Lirim Murrja+Shadije Zili – numër rendor 60,

- Arber Babi – numër rendor 68, Algert Kurti – numër rendor 44, Petrit Dakavelli+Irma Dakavelli – numër rendor 31, dhe Eduart Matmuja+Blerina Matmuja – numër rendor 76.
2. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 1, bashkëlidhur Vendimit nr. 76, datë 28.06.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu”, pallati nr.458, Rruga “Bajram Tusha”, si dhe pallati nr.1062, Rruga “26 Nëntori”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, Mentor Muja – numër rendor 8, Dajana Lumi – numër rendor 3, Avni Shahu – numër rendor 12, Arjan Onuzi – numër rendor 13, Aziz Isufaj+Fllanxa Isufaj – numër rendor 15, dhe Arti Mancka – numër rendor 16.
 3. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 120, datë 30.09.2021 “Për miratimin e disa shtesave në aneksin 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021, përsa i përket listës së përfituesve që do të përfitojë nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati” rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, Dode Nikollaj+Marjana Nikollaj – numër rendor 80, Astrit Murati – numër rendor 79, Ilia Traja+Merita Traja – numër rendor 92.
 4. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 143, datë 12.11.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve në aneksin 2, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.30, datë 26.03.2021, përsa i përket listës së përfituesve që do të përfitojë nga Programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati” rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, duke hequr nga lista emërore e familjeve përfituese nga programi i rindërtimit, Altin Kovaci – numër rendor 102, dhe Erta Spaho – numër rendor 103.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transfertat etj):

-

Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Komisioni i Posaçëm.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e pallatit nr.1032, Rruga “Aleks Komneni”, pallatit “Kastrati”, Rruga “Ramadan Veliu, pallatit nr.458, Rruga “Bajram Tusha”, dhe pallatit nr.1062, Rruga “26 Nëntori”, në territorin e bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, u mbledhë më datë 21.05.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 3 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetarija komisionit hapi mbledhjen. Të pranishëm nga administrata janë zoti Gentian Kallmi dhe Diana Mundia. Komisioni mori në shqyrtim pikën, kërkuar sqarimi nga të pranishmit e administratës pse hiqen këto familje nga lista përfituese nga programi rindërtimit. Kërkohen prova nga hipoteka nëse këto familje kanë dy pronësi. Elisabeta pyet si mund të heqësh nga lista kur nuk kanë shtëpi në Durrës por në një vend tjetër? Genti u shpreh se ka lidhje me pushaportizimin në qytetin ku jepet banesa. Me këtë përgjigje u sqaruan të gjithë antarët që ishin present. Flutra kërkoi listën e hipotekës për secilin banor që janë pjesë e listës. Marsida pyeti për personat e hequr nga lista nëse është kryer procedura e shpërndarjes së banesës. Zoti Genti Kallmi u shpreh se procedura nuk është kryer.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike

Kryetar: Marsida Feshi (emri, mbiemri, firma)

Zv/Kryetar: _____ (emri, mbiemri, firma)

Sekretar: Flutura Lase (emri, mbiemri, firma)

Anëtar: Mataj Elisabetha (emri, mbiemri, firma)

Anëtar: Donia Isak (emri, mbiemri, firma)

Anëtar: Jonida Musaraj (emri, mbiemri, firma)

Anëtar: _____ (emri, mbiemri, firma)

Anëtar: _____ (emri, mbiemri, firma)

Anëtar: _____ (emri, mbiemri, firma)

Diana Haradinaj Gjengj